

**VENDIM**  
**Nr. 527, datë 10.6.2020**

**PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË TAKSËS VJETORE TË MJETEVE TË PËRDORURA, TË VITIT 2020, PËR MJETET E DESTINUARA PËR TRANSPORT UDHËTARËSH, TË KATEGORIVE “M2” DHE “M3”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 2, shkronjat “e” e “ë”, dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kompensimin financiar të taksës vjetore të mjeteve të përdorura (TVMP), të vitit 2020, për mjetet e destinuar për transport udhëtarësh, të kategorive “M2” dhe “M3”. Në masën e kompensimit financiar, krahas taksës vjetore të mjeteve të përdorura, përfshihen dhe gjohet e krijuara për detyrimet e vitit 2020, të lidhura me TVMP-në.

2. Nga ky vendim përfitojnë të gjitha subjektet, individë, persona fizikë ose juridikë, të cilat shfrytëzojnë mjete të transportit rrugor në pronësi, në bashkëpronësi ose me qira, si dhe që ushtrojnë aktivitetin e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

3. Sipas objektivit të veprimtarisë, përfitojnë nga kompensimi financiar të gjitha subjektet që:

a) ushtrojnë veprimtarinë e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit nëpërmjet:

i. shërbimeve në linja të rregullta (transporti qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas);

ii. shërbimeve të rregullta, të specializuara;

iii. transporteve për llogari të vet;

iv. transporteve të rastit.

b) ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve jashtë vendit nëpërmjet:

i. shërbimeve të rregullta;

ii. shërbimeve të rregullta, të specializuara;

iii. shërbimeve të rastit.

4. Nuk përfitojnë nga ky vendim të gjitha subjektet që rezultojnë debitore dhe nuk kanë kryer pagesën e TMVP-së për vitet paraardhëse. Përyjashtimisht, këto subjekte përfitojnë vetëm nëse paguajnë detyrimet e prapambetura brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Subjekteve përfituese, sipas pikës 3, të këtij vendimi, që kanë kryer pagesën e TVMP-së për vitin 2020, kompensimi do t’u bëhet sipas radhës së datës së pagesës së ardhshme, duke i zbritur detyrimin përkatës të paguar tashmë.

6. Vlera e kompensimit për subjektet përfituese përballohet nga fondi rezervë i krijuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**